



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 16. 10.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9902,
DATË 17.4.2008, “PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE”, TË NDRYSHUAR”**

HYRJE

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar”, në mbledhjet e datës 3 korrik, 18 korrik, 25 shtator dhe 16 tetor 2018.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Vullnet Sinaj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin Znj. Albana Shkurta zëvendësministre e ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i propozohet për shqyrtim Kuvendit bazuar në përcaktimet e nenit 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Projektligji shoqërohet nga Shtojca 1, si pjesë përbërëse e tij dhe nga relacioni shpjegues, sipas përcaktimeve të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

1. QËLLIMI DHE PËRMBJATJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar, propozon disa shtesa dhe ndryshime të rëndësishme të ligjit në fuqi dhe

shkrin në përmbajtjen e tij edhe objektin e rregullimit të vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 21.1.2009, “Për kontratat jashtë qendrave të tregtimit”, dhe nr. 64, datë 21.1.2009, “Për kontratat në largësi”.

Objektivi i përgjithshëm i projektligjit është fuqizimi i konsumatorëve nëpërmjet informimit të tyre për shitjet dhe shërbimet që ofrohen në treg, si dhe një mbrojtje më e madhe për ta, duke siguruar që mosmarrëveshjet ndërmjet tyre dhe tregtarëve të trajtohen nga struktura jashtëgjyqësore, që ofrojnë procedura të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, të paanshme, transparente, efektive dhe të drejta, pa i kufizuar të drejtën konsumatorëve për t’iu drejtuar gjykatës, duke kontribuar, kështu, në funksionimin e mirë të tregut të brendshëm. Ky informim konsiderohet mjaft i rëndësishëm për të fuqizuar konsumatorët në treg dhe për t’i mundësuar atyre vendimmarrjen e informuar e të ndërgjegjshme, për realizimin sa më të mirë e të plotë të interesave të tyre.

Projektligji, në përgjithësi, synon vendosjen e ekuilibrave të drejtë në ekonominë e lirë të tregut dhe shmangien e deformimeve dhe mangësive të tregut, mallrave dhe shërbimeve të ofruara ndaj publikut të gjerë.

Objektivat specifikë të projektligjit lidhen me detyrimin për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, sipas përcaktimeve të nenit 70, të MSA-së.

Ky projektligj përfaqëson përmirësimin e fazës së parë të përafrimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes të konsumatorëve. Pavarësisht se kjo fazë është kryer dhe ka pasur një përjasje të konsiderueshme që prej vitit 2008, në këtë moment kërkohet përafrimi i legjislacionit në fushën e të drejtave të konsumatorëve me legjislacionin më të ri dhe bashkëkohor të BE-së, më konkretisht, transpozimi i Direktivës 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2011, “Për të drejtat e konsumatorit”. Ndërsa, për sa i takon zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, ky projektligj transponon Direktivën 2013/11/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 maj 2013, “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve”.

➤ **Përparësitë ndaj legjislacionit aktual**

Projektligji paraqet përparësi të dukshme me legjislacionin aktual, pasi :

- konsolidon dhe thjeshtëson listën e detyrimeve për informacion, që duhet të japin tregtarët ndaj konsumatorëve në treg,
- konsolidon dhe qartëson kërkesat formale për kontratat jashtë qendrave të tregtimit dhe ato në largësi;
- rregullon me hollësi të drejtën për të hequr dorë nga kontratat e sipërcituara, si dhe mënyrën e ushtrimit të saj e pasojat e ushtrimit të kësaj të drejte;
- parashikon llojin e kontratave, ndaj të cilave nuk aplikohet e drejta e heqjes dorë, duke ruajtur, kështu, një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesave të tregtarëve dhe atyre të konsumatorëve;
- qartëson nocionet e dorëzimit të mallit dhe momentin e kalimit të rrezikut të mallrave;

- rregullon në mënyrë të drejtë zgjidhjen e kontratës në rast të mosdorëzimit të mallit nga ana e tregtarit brenda afatit;
- parashikon edhe ndalimin e tarifave të tepërta e të paarsyeshme për shkak të përdorimit të mjeteve të ndryshme të pagesës ose në përdorimin e telefonatave për të kontaktuar tregtarin.

➤ **Risite që sjell projektligji:**

- ndryshime në fushën e zbatimit të ligjit, duke parashikuar më qartësisht zbatimin e këtij akti ligjor në raport me ligjet e tjera;
- ndryshime dhe shtesa në listën e përkufizimeve të parashikuara nga ligji në fuqi;
- parashikimi i përjashtimeve nga fusha e zbatimit, ku përcaktohet se kontratat e shërbimit social, atij shëndetësor, për lojërat e fatit, shërbimet financiare, tjetërsimi i sendeve të paluajtshme, ndërtimi i ndërtesave të reja, për paketat e udhëtimit, përdorimit me afat të produktit të pushimit afatgjatë, etj. përjashtohen nga zbatimi i pjesës VI, të ligjit 9902/2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar;
- parashikimi i dispozitave lidhur me informacionin parakontraktor për konsumatorin në kontrata të ndryshme nga ato të lidhura në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit;
- detyrimi për informacion në kontrata të ndryshme nga ato të lidhura në largësi apo jashtë qendrave të tregtimit.
- përfshirja në kontratë e detyrimit për dhënien e informacionit si pjesë përbërëse e kushteve kontraktore, pasojat në rastin e mosdhënies së informacionit, barra e provës për informacionin e dhënë ndaj konsumatorit, e cila bie mbi tregtarin;
- detyrimi i formës së shkruar të kontratave të lidhura jashtë qendrave të tregtimit, për efekte provueshmërie;
- forma e lidhjes së kontratave në largësi, duke mos penguar zbatimin e dispozitave të ligjit për tregtinë elektronike;
- të drejtën e heqjes dorë nga kontrata dhe detyrimet e konsumatorit në rast të ushtrimit të heqjes dorë nga kontrata;
- kalimin e rrezikut të humbjes së mallit, i cili i kalon konsumatorit vetëm pasi i është dorëzuar atij apo përfaqësuesit të tij;
- parashikimin e dispozitave mbi pavlefshmërinë e kushteve kontraktore që heqin ose kufizojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj;
- parashikimin e dispozitave mbi funksionimin e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të procedurave dhe të respektimit të kritereve në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve nga strukturat përgjegjëse;
- krijimin e një strukture përgjegjëse për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, pranë ministrisë;
- dispozita mbi ankesat e konsumatorëve, të cilat tashmë mund t’i paraqesin edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

➤ **Institucionet që ngarkohen për zbatimin e projektligjit:**

1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
2. Enti Rregullator i Energjisë;
3. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
4. Enti Rregullator i Ujit;
5. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
6. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar;
7. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

➤ **Efektet në buxhetin e shtetit**

Transpozimi i dy direktivave 2011/83/BE, “Për të drejtat e konsumatorit”, dhe 2013/11/BE “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve” nuk ka implikime imediate financiare për buxhetin e shtetit.

Ndërkohë, struktura përgjegjëse ZAM, që kryen funksione të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të tjera nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, përcaktuar në projektligj për t’u krijuar pranë ministrisë që mbulon fushën e mbrojtjes së konsumatorëve, parashikohet të ngrihet në vitin 2020.

Kostot e nevojshme të ngritjes dhe funksionimit të saj kanë një vlerë prej 15 milionë lekë dhe këtu përfshihen: pajisjet e zyrave, pagat e punonjësve, shpenzime operative, etj. Kjo kosto do të parashikohet për buxhetin e vitit 2020, me anë të ndryshimeve përkatëse të PBA, brenda tavaneve buxhetore të miratuara për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

II. PROCESI I SHQYRTIMIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi projektligjin në mbledhjet e datave 3 korrik, 18 korrik, 25 shtator dhe 16 tetor 2018.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin zëvendësministrja e ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Znj. Albana Shkurta dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Pas prezantimit të detajuar të projektligjit nga relatori i caktuar nga Komisioni, përfaqësuesit e ministrisë në mënyrë të përmblodhur prezantuan edhe një herë nevojën që ka çuar në kryerjen e këtyre ndryshimeve. Nevoja e ndryshimeve në projektligj vjen si një detyrim në favor të konsumatorit. Për shkak të evoluimit që ka pësuar tregu, vendosja e ekuilibrave midis tregtarit dhe konsumatorit, është një detyrim për të garantuar zgjidhje alternative.

Ndryshimet në projektligj do të krijojnë lehtësi në marrjen e shërbimeve më të rëndësishme të qytetarëve shqiptarë, që do të thotë se sot të gjitha entet rregullatore shtetërore do të kenë strukturat e tyre të posaçme, të cilat i kanë vendosur edhe në ligje specifike dhe do të merren vetëm me çështjen e mbrojtjes së konsumatorit. Ato do të jenë struktura të pavarura, transparente dhe do të monitorohen në mënyrën se si do t'u shërbejnë qytetarëve. Kjo do të ngrejë edhe nivelin e shërbimeve në institucionet shtetërore, por në të njëjtën kohë do të rrisë dhe nivelin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Pyetjet e deputetëve u përqendruan në çështje që lidhen me informimin për produktet dhe shërbimet, me nevojën për krijimin e një *website* ku lehtësisht konsumatorët me disa klikime të arrijnë të verifikojnë nëse një produkt, të cilin e ndeshin në treg, etj.

Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se katalogu i produkteve sipas specifikave të tyre po hartohet nga Inspektorati i Mbikëqyrjes së Tregut, i cili është bërë operacional që prej një viti. Lista e produkteve do të hartohet bazuar në inspektimet që po bën ky institucion dhe do të publikohet në *website*-in e tyre.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni zhvilloi dhe një seancë dëgjimore me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut. Përfaqësuesit e këtij institucioni u shpjeguan deputetëve se ky inspektorat është një institucion i ri i krijuar nga Këshilli i Ministrave në janar të vitit 2016, pas sugjerimeve dhe rekomandimeve të vazhdueshme të Bashkimit Evropian, por edhe të nevojës së brendshme të tregjeve, dhe të konsumatorëve. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut ka tri fusha kryesore veprimtarie: Drejtoria e Inspektimit të Sigurisë së Përgjithshme të Produktit, Drejtoria e Inspektimit të Standardit në Turizëm dhe Drejtoria e Inspektimit të Pronësisë Intelektuale, ku përfshihet e drejta e autorit dhe pronësia industriale, pra markat dhe patentat.

Lidhur me raportin e veprimtarisë së këtij institucioni me projektligjin e propozuar, përfaqësuesit e ISHMT shpjeguan se ky institucion vepron vetëm në pjesën e sanksioneve, për sa u përket detyrimeve që ligji aktual, nenet 7,8 dhe 9 referojnë për informimin vizual, specifik dhe të dukshëm që duhet të ketë produkti për elementet e etiketimit. Pra, lidhur me detyrimin që çdo produkt duhet të ketë etiketën në shqip, peshën, çmimin në lek dhe periudhën e garancisë përtej produkteve ushqimore.

III. RREGULLIME TË TEKNIKËS LEGJISLATIVE DHE RIFORMULIME TË MIRATUARA NË KOMISION

Në **përfundim të diskutimeve**, Komisioni, me shumicë votash, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, pasi u njoh edhe me raportin e Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dhe të Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian, u shpreh dakord me propozimet e paraqitura prej tyre, duke i bërë pjesë të vërejtjeve të tij si më poshtë:

1. Shënimi në fund të fages që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- *Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 25 Tetor 2011 “Mbi të drejtat e konsumatorit, e cila ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13/KEE dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe Direktivën 97/7/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, e ndryshuar. Numri CELEX 32011L0083, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 304, datë 22.11.2011, faqe 64 - 88.*
- *Direktivën 2013/11/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 Maj 2013 “Për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve të konsumatorëve, e cila ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 2006/2004 dhe Direktivës 2009/22/KE”, (Direktiva për Zgjidhjen Alternative të Mosmarrëveshjeve (ZAM) konsumatore); numri CELEX: 32013L0011, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.06.2013, fq. 63-79.”*

2. Neni 1 të riformulohet si vijon:

”Neni 1

Në nenin 2, fjalia e dytë shfuqizohet dhe shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Zbatimi i dispozitave të këtij ligji nuk cenon zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë sektorët e veçantë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Dispozitat e këtij ligji zbatohen dhe për ato çështje që nuk rregullohen nga legjislacioni i posaçëm”.

3. Në nenin 2 të projektligjit, të bëhen këto ndryshime:

1. në pikën 3, që ndryshon pikën 7, fjalia e parë të riformulohet :

“Mall për konsumatorët”, më poshtë mall, është çdo send i luajtshëm, i trupëzuar, me përjashtim të sendeve që janë objekt i shitjes së detyrueshme apo të një forme tjetër të parashikuar me ligj”;

2. Pika 4, që shton pikën 7.1, të riformulohet si vijon:

”4. Pas pikës 7 shtohet pika 7.1, me këtë përmbajtje:

”7.1. “Mallra të bëra sipas specifikimeve të konsumatorit”, janë mallra të parafabrikuara, të bëra në bazë të zgjedhjes personale apo vendimit të konsumatorit””.

3. Në pikën 6 të bëhen këto ndryshime:

a. Në pikën 20, fjalia e dytë të riformulohet si vijon:

“Objekt i kësaj kontrate janë mallrat dhe, sipas rastit, dhe shërbimet që i shoqërojnë ato.”

b. **Në pikën 27**, fjala “metodë” të zëvendësohet me fjalën “procedure”;

c. **Pika 31** të riformulohet si vijon:

“31. Struktura ZAM”, është një strukturë e përhershme, përgjegjëse për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje përmes një procedure të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve sipas parashikimeve të këtij ligji.”

4. **Në nenin 7 të projektligjit, që ndryshon nenin 34 të ligjit**, pikat 2 dhe 3 të riformulohen si vijon:

“2. Dispozitat e pjesës VI, të këtij ligji, nuk zbatohen në rastet kur parashikohet ndryshe në legjislacionin që rregullon sektorë të veçantë.

3. Për aspekte të përgjithshme të së drejtës së kontratave që nuk rregullohen nga ky ligj, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil mbi veprimet juridike dhe kontratat, në lidhje me rregullat për vlefshmërinë, krijimin apo efektin e një kontrate.”

5. **Në nenin 8 të projektligjit, që shton nenin 34/1 të ligjit**, në shkronjën “a”, para fjalëve “të përhershme apo të përkohshme” të shtohet fjala “në mënyrë”;

6. **Në nenin 10 të projektligjit, që ndryshon nenin 35 të ligjit, në pikën 1** të hiqen fjalët “nëse ky informacion nuk është ndërkohë i qartë nga konteksti”;

7. **Në nenin 12 të projektligjit, që ndryshon nenin 36 të ligjit, dhe në gjithë tekstin e këtij ligji:**

1. Shprehja “identitet tregtar” të zëvendësohet me shprehjen “emrin e regjistruar të tregtarit, sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare;”

2. Shprehja “Adresa gjeografike” të zëvendësohet me shprehjen “Adresa postare”.

8. **Në nenin 14 të projektligjit, që ndryshon nenin 37 të ligjit, në pikën 3**, pas fjalës “website” të shtohen fjalët “duhet të”;

9. **Në nenin 15 të projektligjit**, në titujt e neneve 37/4, 37/5, 37/6 dhe 37/8, në fund, të shtohen fjalët “nga kontrata”;

10. **Në nenin 16 të projektligjit, që shton Kreun III, të bëhen këto ndryshime:**

1. Në nenin 37/11 që shtohet, fjala “tarifa” të zëvendësohet me fjalën “të cilat”;

2. Në nenin 37/12 që shtohet, titulli të bëhet: *“Kalimi i rrezikut të humbjes ose dëmtimit të mallrave”*.

11. **Në nenin 18 të projektligjit, që ndryshon nenin 52 të ligjit, në pikën 11 që shtohet,** fjalët “sipas kërkesës” të vendosen pas togfjalëshit “përmes një mjeti komunikimi të qëndrueshëm”.

12. **Në nenin 19 të projektligjit, të bëhen këto ndryshime:**

1. **Në nenin 52/3 që shtohet;**

a. **Në pikën 1, pas shkronjës “c”** të shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) përpunimin e të dhënave personale, duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale të parashikuara në ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar””.

b. **Në pikën 3, në shkronjën f),** togfjalëshi “duke përfshirë penalitetet për mospërfshirëshmëri” të zëvendësohet me togfjalëshin “duke përfshirë sanksionet për moszbatimin”;

2. **Në nenin 52/4 që shtohet:**

a. **në pikën 1, shkronja “c”** të riformulohet si më poshtë:

“c) mosmarrëveshja është duke u shqyrtuar ose është shqyrtuar më parë nga një strukturë tjetër e ZAM, nga një ndërmjetës i licencuar, ose nga gjykata;”

b. **Në pikën 3,** referenca “në shkronjën “d”, të korrigjohet dhe të bëhet “në shkronjën ‘ç’”;

3. **Në nenin 52/5 që shtohet, në pikën 1:**

a. **shkronja “c”** të riformulohet :

“c) Procedura e ZAM është pa pagesë për konsumatorin”;

b. në shkronjën “dh” , të korrigjohet referenca sipas shkronjës “d”, dhe të bëhet “sipas shkronjës ‘ç’”;

13. **Neni 20 i projektligjit,** të bëhet neni 18, pasi parashikon ndryshime në nenin 51 të ligjit.

14. Në nenin 22 të projektligjit, që ndryshon nenin 56, në pikën 1, shkronja “c” të riformulohet si vijon:

“c) Në shkronjën “ç”, shtohen fjalët “... ose ndërmjetësi i licencuar ...”;

15. Neni 25 i projektligjit të riformulohet si vijon:

“Neni 25

Dispozitë kalimtare

- 1. Deri në krijimin e strukturës përgjegjëse të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve të tjera, nga ato që lidhen me shërbimet me interes publik, sipas parashikimit të nenit 52/6, të këtij ligji, përgjegjësitë dhe funksionet kryhen nga Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve.*
- 2. Strukturat ZAM të parashikuara në nenin 52/2, pika 1, të këtij ligji ushtrojnë funksionet e parashikuara në këtë ligj, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.”*

16. Pas nenit 25 të shtohet neni 25/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 25/1

Nxjerrja e akteve nënligjore

- 1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në zbatim të nenit 52/6, pika 3, dhe nenit 56, pika 2, të ligjit, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.*
- 2. Aktet nënligjore, të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që bien në kundërshtim me të, shfuqizohen.”*

17. Në gjithë përmbajtjen e projektligjit të hiqen referencat në nene të caktuara të ligjeve të tjera.

18. Të bëhet rinumërtimi i neneve sipas ndryshimeve të miratuara.

RELATOR

Vullnet SINAJ

KRYETAR

Eduard SHALSI